

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Shukri Sylejmani dhe Muhamet Rexha, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve R. G. dhe B. R., të dytë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson F. Ç. - Kabashi, avokate nga Prizreni, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson A. Sh., jurist i diplomuar, për shkak të kompensimit të dëmit, përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr. 189/2014 datë 10.5.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 13.10.2016, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 189/2014 datë 10.5.2016.

Pjesa e aktgjykimit për dëmin material të shkaktuar në automjetin e të paditurit të dytë nuk u shqyrtua.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr. 189/2014 datë 10.5.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore, Prizren, C.nr.114/2013 datë 10.4.2013, në pjesën I të dispozitivit, për ndihmën nga personi tjetër, ushqimin e përforcuar, shpenzimeve të mjekimit, si dhe në pjesën IV të dispozitivit, që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës. Me pjesën II. të dispozitivit, është aprovuar pjesërisht si e bazuar ankesa e të autorizuarit të paditësit R.G., nga Prizreni, ndërsa aktgjykimi i atakuar në pjesën e dispozitivit e cila ka të bëjë me dhimbje fizike, zvogëlimin e aktivitetit jetësor, frikën e pësuar, shëmtimin trupor dhe fitimin e humbur, si dhe

pjesët II e III të dispozitivit janë ndryshuar dhe gjykuar si në vijim: paditësit R. G. nga Prizreni, për dëmin jo material e paditura t'ia paguaj dhe atë: për dhimbje fizike shumën prej 4.500 €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor shumën prej 12.000 €, për frikën e pësuar shumën prej 3.500 €, në emër të shëmtimit trupor shumën prej 2.500 €, si dhe për dëmin material: kompensim të rentën e arritur për periudhën 18.7.2008 deri më datën 31.1.2010, për 55 %, të zvogëlimit të aftësisë punuese , t'i paguajë shumën prej 2.091,72 €, ndërsa për periudhën e ardhshme prej datës 1.2.2010, e tutje në emër të rentës mujore t'ia paguajë çdo muaj shumën prej 110 €, derisa të ekzistojnë kushtet ligjore. Me pjesën III. të dispozitivit, është vendosur që nga shuma totale e gjykuar me këtë aktgjykim, të zbritet shuma prej 2.000 €, aq sa ka pranuar paditësi i parë, në emër të paradhënies prej të paditurës, si dhe çdo pagesë tjetër eventuale të kryer nga e paditura për paditësin e parë. Me pjesën IV. të dispozitivit, është refuzuar si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së precizuar të paditësit.

E paditura me kohë ka paraqitur revizion kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen lidhur me shumat e gjykuara, ose ato të prishen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi aktgjykimin e kundërshtuar konform nenit 215 të LPK -ës dhe gjeti se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se më datë 18.7.2008, vozitësi N. D., duke drejtuar traktorin e markës "IMT 539" me targa të regjistrimit ..., pa ndriçim, në kundërshtim me rregullat e komunikacionit, ka penguar pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, ashtu që paditësi R. G. duke drejtuar automjetin e markës "Damler Benz" me targa të regjistrimit ... , me pjesën e përparme të automjetit e ka goditur traktorin në pjesën e prapme , me ç'rast paditësi R. G., pëson lëndime të rënda trupore, që si pasojë i kanë shkaktuar dhimbje fizike, frikë, shëmtim trupor, zvogëlim të aktivitetit jetësor 40%, i janë shkaktuar shpenzime për ushqim të përforcuar, ka pas nevojë për ndihmën nga personi tjetër, i janë shkaktuar shpenzime për shërim dhe humbje të fitimit për

shkak të mundësisë së zvogëluar për punë, ndërsa në automjetin e të paditurit të dytë është shkaktuar dëm i konsiderueshëm material.

Në bazë të kësaj gjendje të vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, duke konsideruar se lartësia e aprovuar në emër të shpërblimit të dëmit jo material e material, është shpërblim real dhe objektiv, pastaj ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të asaj gjykate.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën sipas ankesës ka vlerësuar se ankesa e të paditurës është tërësisht e pabazuar dhe pretendimin e të paditurës se këto shuma janë tepër të mëdha i ka vlerësuar si të pabazuara, ndërsa pjesërisht ka pranuar ankesën e paditësit, ashtu që ka gjykuar shumat e cekura si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit pjesërisht është e bazuar. Gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me zbatimin e të drejtës materiale, kur ka gjykuar shumat për kompensim të cilat duhet t'i paguajë e paditura paditësit, të cilat arsye i mbështetë edhe kjo Gjykatë e revizionit.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit të parë është pjesërisht e bazuar dhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate mbi gjendjen e tillë faktike gjykata e shkallës së dytë drejt ka zbatuar dispozitat e nenit 200 të LMD -ës lidhur me nenin 323 të LPK -ës, me rastin e aprovimit të pjesërishtëm të ankesës së paditësit të parë përkitazi me caktimin e lartësisë së dëmit jo material, ngase, shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së dytë janë caktuar në bazë të ekspertizës mjekësore nga eksperti Dr. V. B. mr.sc – ortoped traumatolog dhe Dr. N. F., neuropsikiatër, në bazë të intensitetit të dhimbjeve fizike, intensitetit të frikës së pësuar, në bazë të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe për shëmtim.

Vërtetimi i shpërblimit (satisfaksioni) për dëmin jo material përfaqëson zbatimin e të drejtës materiale. Gjatë caktimit të lartësisë së shpërblimit për format e caktuara të dëmit jo material, gjykata sipas nenit 200 të LMD duhet të kujdeset për rëndësinë e të mirës së dëmtuar dhe qëllimit së cilit i shërben ai shpërblim, por edhe për atë që me të favorizojnë synimet të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të tillë të dëmit jo material dhe qëllimit shoqëror. Duke pasur parasysh kriteret e parapara me këtë dispozitë, rëndësinë e vlerave të dëmtuara të paditësit, shkallën e intensitetit dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike dhe frikës, shëmtimit trupor dhe zvogëlimit të aktivitetit jetësor, sipas gjendjes së vërtetuar me anë të ekspertizës, e duke pasur parasysh praktikën e gjertanishme të gjykatave në Kosovë, shumat e caktuara të shpërblimit të dëmit paditësit nga ana e gjykatës së shkallës së dytë sipas vlerësimit të kësaj Gjykate janë reale dhe në përputhje me kriteret e parapara sipas kësaj dispozite, për të cilën arsye gjykata e shkallës së dytë drejt ka zbatuar të drejtën materiale.

Lidhur me shpenzimet për ushqim të përforcuar dhe për ndihmën e personit tjetër, gjykatat e instancës më të ulët, të njëjtat i kanë caktuar në bazë të mendimit të ekspertëve të cilat kanë argumentuar se paditësi ka pas nevojë për ushqim të përforcuar dhe ndihmën nga personi tjetër, andaj edhe pretendimet e cekura në revizion në këtë drejtim, Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi si të pabazuara.

Pretendimin e cekur në revizion se gjykata e shkallës së dytë ka tejkaluar kërkesëpadinë e paditësit të parë, ngase në hyrjen e dispozitivit është shënuar vlera e kontestit në shumën prej 9.583 €, ndërsa në dispozitivë qëndrojnë shuma tjera, Gjykata Supreme e Kosovës e shqyrtoi por e njëjta nuk pati ndikim për të vendosur ndryshe, ngase, në procedurën përmbarese ekzekutohet dispozitivi i aktgjykimit, i cili sipas kësaj Gjykate është i qartë dhe i përmbareshëm.

Pretendimi se gjykata e shkallës së dytë ka zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale me rastin e caktimit të rentës, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, ngase gjykatat e instancës më të ulët llogaritjen e fitimit të humbur – rentës e kanë gjykuar në

bazë të mendimit të ekspertit të aktuaristikës dhe financave i cili mendimin e tij e ka bazuar në bazë shkencore dhe provat konkrete.

Pjesa e aktgjykimit lidhur me dëmin e pësuar material në automjetin e të paditurit të dytë për automjetin e dëmtuar nuk është goditur me revizion , andaj e njëjta nuk u shqyrtua në këtë pjesë.

Nga sa u tha më lart, e në pajtim me nenin 222 të LPK -ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SURPEME E KOSOVËS – PRISHTINË

Më 13.10.2016, Rev.nr.229/2016

Kryetarja e kolegjit,

Emine Kaçiku